

Dhjetëshi i
fundit i
Ramazanit



Dhjetëshi i
fundit i
Ramazanit



Titulli:

Dhjetëshi i fundit i Ramazanit

Autorë:

Agron Krasniqi

Vjosa Kabashi

Kopertina:

Arbër Deva

Faqosja:

Agron Krasniqi

Riad, 1442 h / 2021

- **Hyrje**
- **Vlera e dhjetëshit të fundit**
- **Nata e Kadrit dhe vlera e saj**
- **Kur është nata e Kadrit?**
- **Udhëzimi i të Dërguarit në dhjetëshin e fundit**
- **Cili adhurim është më i dobishëm gjatë këtyre netëve?**
- **Si ta arrijmë (në praktikë) shpërblimin e Natës së Kadrit?**

Hyrje

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë, atë që e udhëzon Allahu s'ka kush e humbë, dhe atë që e humbë Allahu s'ka kush e udhëzon.

Dëshmojmë dhe deklarojmë se s'ka të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, familjen e tij, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij. Më pastaj:

Falënderojmë Allahun i Cili me urtësinë dhe mëshirën e Tij, ka veçuar disa kohë nga të tjerat, disa muaj nga të tjerët, disa ditë nga të tjerat; ashtu që, ka dalluar në vlerë muajin Ramazan nga muajt tjerë, pastaj, ka dalluar dhjetë netët e fundit të muajit Ramazan nga të tjerat, e mes këtyre dhjetë netëve ka dalluar **Natën e Kadrit** e cila është më e vlefshme se një mijë muaj. Ka dalluar dhjetë ditët e muajit Dhul Hixhe nga ditët tjera, mes këtyre ditëve ka dalluar ditën e Arafatit dhe ditën e Kurban Bajramit. Dhe ka dalluar ditën e Xhuma nga ditët tjera të javës, pastaj ka dalluar çastin e fundit të ditës së xhuma nga pjesa tjetër e kësaj dite. E kështu me radhë.

Këto janë kohë sezonale -nëse mund t'i quajmë kështu-, të cilat përsëriten vazhdimisht, ku në to shumëfishohen

veprat e mira, kohë të cilat, Allahu i Madhëruar i ka caktuar si dhuratë për ne, ashtu që kush ka mangësi në veprat apo obligimet e tij, i gjen këto kohë – sezona, si mundësi për ta kompensuar atë që ka lënë mangut, e gjitha kjo mundësi apo dhunti është në shërbim të qëllimit kryesor për të cilin është krijuar njeriu, e ai është **adhurimi i Allahut të Vetëm**.

Duhet theksuar se nga urtësitë dhe qëllimet parësore të çdo adhurimi të cilin Allahu i Lartësuar e ka ligjësuar t'i kushtohet Atij, është: pastrimi dhe dëlirësia e shpirtërave, rregullimi i zemrave, arritja e devoshmërisë dhe kultivimi i saj te besimtarët, largimi nga të këqijat dhe fshirja e gjynaheve.

Allahu i Lartësuar në suren Maide, -pasi përmend dispozitat dhe formën e abdesit për falje të namazit-, thotë:

{مَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِنْ حَرَجٍ وَلَكِنْ يُرِيدُ لِيُطَهَّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ} [المائدة: ٦]

"Allahu (me këto dispozita) nuk dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, ashtu që të jeni falënderues". (Maide, 6)

Pra, me këto adhurime që kërkon ndaj nesh dëshiron të na pastrojë.

Po ashtu thotë për namazin:

{وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَى عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ} [العنكبوت: ٤٥]

"Dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja (imoraliteti) dhe nga çdo vepër e shëmtuar".
(Ankebut, 45)

Dhe thotë për zekatin:

{خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا} [التوبة: ١٠٣]

"Merr nga pasuria e tyre lëmoshë (zekatë) ashtu që me të t'i pastrosh ata dhe t'ua shtosh veprat e mira!".
(Teube, 103)

Këtë qëllim fare mirë Allahu i Lartësuar e thekson në Kuran edhe për agjërimin, ku thotë:

{يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ} [البقرة: ١٨٣]

"O besimtarë! Ju është bërë obligim agjërimi, ashtu si u ishte bërë obligim atyre para jush, kështu që të bëheni të devotshëm". (Bekare, 183)

Ndërsa për kryerjen e Haxhit, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"مَنْ حَجَّ هَذَا الْبَيْتَ فَلَمْ يَزُفْ وَلَمْ يَغْسُقْ رَجَعَ كَمَا وَلَدَتْهُ أُمُّهُ".

***"Kush kryen haxhin në këtë shtëpi (Qabe) dhe nuk i afrohet gruas dhe nuk bën ndonjë gjynah, kthehet sikur në ditën që e ka lindur nëna e tij"*⁽¹⁾.**

Pra, kthehet i pastër nga gjynahet, sikur që ishte në momentin kur e ka lindur nëna.

Prandaj, qëllimi dhe urtësia nga çdo adhurim në përgjithësi dhe nga agjërimi në veçanti: është pastrimi i shpirtit nga gjynahet, dëlirësia dhe devotshmëria e tyre.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi ﷺ ka thënë:

***"Atij që e agjëron Ramazanin me besim dhe me shpresë, do t'i falen gjynahet e kaluara"*⁽²⁾.**

Pra, i falen gjynahet ashtu që të jetë i pastër, i dëlirë e që më pas të jetë i denjë për të hyrë në Xhenet.

Siç thotë, po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ:

***"Kush beson Allahun dhe të Dërguarin e Tij, falë namazin dhe agjëron Ramazanin, është detyrë për Allahun ta shpie në Xhenet..."*⁽³⁾.**

(1) Shënojnë Buhariu (1819) dhe Muslimi (1350).

(2) Shënojnë Buhariu (2014) dhe Muslimi (760).

Këto vlera dhe shumë të tjera në përgjithësi që përmenden, e dallojnë muajin Ramazan nga muajt tjerë, ndërsa gjëja kryesore me të cilin veçohet agjërimi apo muaji Ramazan në përgjithësi është: **dhjetëshi i fundit** i tij, për të cilin do të flasim më gjërësisht në kapitujt në vijim.

(3) Shënon Buhariu (2790).

Vlera e dhjetëshit të fundit

Prej vlerave dhe dobive që kanë këto dhjetë ditë mund të përmenden:

1. Këto dhjetë ditë janë nga ditët më me vlerë tek Allahu i Madhëruar, saqë dijetarët kanë diskutuar se a janë më me vlerë këto dhjetë ditë të fundit të Ramazanit apo dhjetë ditët e Haxhit në muajin Dhul Hixhe, ku edhe për këto të fundit kanë ardhur argumente të shumta që flasin për vlerën e tyre, në to është Dita e Kurbanit të Bajramit, për të cilën i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë se është dita më e mirë e vitit, po ashtu dita e Arafatit, ditët e teshrikut – qëndrimit në Mina, e kështu me radhë.

Në anën tjetër, dhjetëshi i fundit i Ramazanit e përmban **Natën e Kadrit**, e cila është nata më me vlerë, e cila tek Allahu i Lartësuar vlen sa një mijë muaj, në to zbresin melekët, është natë mubarake – e bereqetshme, etj., siç do të përmendim më pastaj.

Atëherë, duke u nisur nga kjo, mendimi më i saktë të disa dijetarë, si **Ibn Tejmije** e të tjerë, qëndron se: sa i përket ditëve, më me vlerë janë ato të muajit Dhul Hixhe, për shkaqet që u përmendën, ndërsa sa i përket netëve, më me vlerë janë dhjetë netët e fundit të

Ramazanit, sepse në to është **Nata e Kadrit**, Allahu e di më së miri.

2. Nga vlerat më të mëdha të këtyre ditëve, qëndron fakti se në to ka zbritur shpallja, Kurani famëlartë, libri i Allahut, fjala e Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

{شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ
وَالْفُرْقَانِ} [البقرة: ١٨٥]

"Muaji Ramazan është që në të zbriti Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)". (Bekare: 185)

Ky Kuran, të cilin Allahu e ka bërë udhëzues për njerëzimin, mëshirë për besimtarët, këshillë për ta dhe shërim për gjoksat e tyre.

3. Për shkak të vlerës së tyre, i Dërguari i Allahut ﷺ i madhëronte këto ditë duke shtuar adhurimin në to.

Aisheja (radijallahu anha) tregon se: "Kur hynte dhjetëshi i fundit i Ramazanit, i Dërguari ﷺ shtrëngonte rripin, gjallëronte natën me adhurim dhe e zgjonte familjen e tij"⁽⁴⁾.

(4) Shënojnë Buhariu (2024) dhe Muslimi (1174).

4. Po ashtu, të parët tanë të mirë, sahabët - shokët e të Dërguarit ﷺ dhe gjeneratat pas tyre, i madhëronin këto dhjetë ditë, duke shtuar përpjekjet e tyre në adhurim dhe duke u përkushtuar në to në kërkim të mirësive të Allahut, me të cilat i ka veçuar këto ditë.

Ebu Othman en Nehdi - nga tabi'inët e shquar, - thoshte: "*Ata -shokët e të Dërguarit ﷺ - i madhëronin tri dhjetëshe:*

- *dhjetëshin e fundit të Ramazanit,*
- *dhjetëshin e parë të Dhul Hixhes, dhe*
- *dhjetëshin e parë të muajit Muharrem*"⁽⁵⁾.

5. Ngase në këto ditë është nata më me vlerë në mbarë vitin, ajo është **Nata e Kadrit**, për të cilën është e domosdoshme të flitet më gjatë në kapitullin vijues.

(5) Shënon Merveziu në "Muhtesar Kijam el Lejl", (f. 247).

Nata e Kadrit dhe vlera e saj

Të flasësh për **Natën e Kadrit** është shumë, me këtë natë lidhet i gjithë Ramazani dhe se thelbi i vlerave dhe mirësive të Ramazanit në përgjithësi dhe dhjetëshit të fundit në veçanti, qëndron pikërisht në ekzistimin e kësaj nate në to.

- **Kuptimi: el kadr**

Në gjuhën arabe fjala "**el kadr**" ka disa kuptime, tri prej tyre përdorën konformë kuptimit terminologjik të saj:

I Pari: "el kadr": Pozitë e lartë dhe e çmuar. Pra, natë e lartë me famë dhe vlerë të çmuar.

I dyti: "el kadr" – (التضييق) ngushtësim; është thënë në këtë natë ngushtohet toka, për shkak të numrit të madh të melekëve që zbresin atë natë siç do ta përmendim në vijim.

I treti: "el kadr" – (التقدير) përcaktimi, ku në këtë natë përcaktohen ngjarjet dhe ndodhitë që do të ndodhin përgjatë një viti, siç do ta sqarojmë më pas⁽⁶⁾.

Andaj, në vijim disa nga vlerat e kësaj nate madhështore:

(6) Shih: "Mustalahat fi Kutub el Akaid" (f. 171), "Hutab ue Durus" (18/106).

1. *Në këtë natë ka zbritur Kurani, libri i Allahut.*

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

{إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ} [القدر: ١]

"Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit". (el Kadr, 1)

Nga shoku i të Dërguarit ﷺ, **Abdullah ibn Abasi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmetohet se ka thënë:

"Kurani si tërësi (i kompletuar) ka zbritur në qiellin e dunjasë, natën e Kadrit, pastaj është ndarë (pjesë – pjesë) për t'u zbritur pastaj në vitet me radhë"⁽⁷⁾.

Në një transmetim tjetër, thotë:

"...u vendosë (Kurani) në 'shtëpinë e krenarisë' (بيت العزة) në qiellin e dunjasë, mëtej Xhibrili (alejhi selam) ia zbritte atë të Dërguarit ﷺ dhe ia recitonte atij varg pas vargu"⁽⁸⁾.

Pra, Kurani ka zbritur në muajin Ramazan, në natën e kadrit, nga Pllaka e Ruajtur (اللوح المحفوظ) në qiellin e dunjasë, pastaj Xhibrili (alejhi selam) me lejen e Allahut e zbritte tek i Dërguari ﷺ pak nga pak sipas ndodhive e

(7) Shënon Nesaiu në "es Sunen el Kubra" (11501).

(8) Po aty (7937).

ngjarjeve, për 23 vite me radhë, aq sa edhe ka zgjatur shpallja.

2. Në këtë natë Allahu i Lartësuar i përcakton ndodhitë dhe vendimet që ndodhin përgjatë vitit në vijim.

Allahu i Lartësuar thotë:

{إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ مُبَارَكَةٍ إِنَّا كُنَّا مُنْذِرِينَ (۳) فِيهَا يُفْرَقُ كُلُّ أَمْرٍ
حَكِيمٍ} [الدخان: ۳، ۴]

"Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar, vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues.

Në atë (natë) vendoset çdo punë e urtë". (ed Dukhan, 3-4)

Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se: *"Shkruhet në Librin Amë (أم الكتاب) në natën e kadrut ajo që do të jetë (ndodhë) përgjatë një viti, si: rrizku, jeta, vdekja, shiu, saqë shkruhen edhe haxhilerët, se do ta kryejë haxhin filani e filani"*⁽⁹⁾.

Imam **Ikreme** (104 h) – nxënësi i Ibn Abasit- thotë: *"Në natën e kadrut, shkruhen haxhilerët që do ta kryejnë haxhin në shtëpinë e Allahut (Qabe) me emrat e tyre dhe*

(9) "Tefsir Ibn Ebi Hatim" (18527).

emrat e baballarëve të tyre, nuk mungon asnjë prej tyre, e as nuk shtohet asnjë nga ata (të shkruarit)"⁽¹⁰⁾.

Komentuesi i njohur i Kuranit, imam **Muxhahidi** (104 h), te ky ajet kuranor, ka thënë se është fjala: "*Në natën e kadrit, (shkruhet) çdo gjë që do të ndodhë nga viti në vitin tjetër, si: jeta e vdekja, përcaktohen në të furnizimet (rrizku) e fatkeqësitë, që të gjitha ato*"⁽¹¹⁾.

Imam **Katade** (117 h) thotë: "*Ajo është nata e kadrit, në të përcaktohet çdo gjë prej vitit në vit*"⁽¹²⁾.

Imam **Hasen el Basriu** (110 h) u pyet: **Nata e Kadrit** a është në çdo Ramazan?

Tha: "Po vallahi! Ajo vërtet është në çdo Ramazan, është natë në të cilën vendoset çdo punë e urtë, në të Allahu e cakton çdo afat (exhel), shpresë dhe furnizim (rrizk) deri në natën tjetër si kjo (pas një viti)"⁽¹³⁾.

3. Kjo natë -Nata e Kadrit- vlen më shumë se një mijë (1000) muaj.

Allahu i Lartësuar thotë:

{ لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ } [القدر: ٣]

(10) "Musanefi" i Ibn Ebi Shejbes (15860).

(11) "Tefsiri" i Taberiut (21/8).

(12) Po aty (21/9).

(13) Po aty (21/7,8).

"Nata e kadrut është më e mirë se një mijë muaj. (el Kadr, 3)

Imam **Muxhahidi** (104 h) thotë: *"Ishte një njeri nga bijtë e Israilit, i cili falej natën deri në mëngjes, pastaj gjatë ditës luftonte armikun deri në mbrëmje, veprroi kështu për një mijë muaj, atëherë Allahu i Madhëruar zbriti ajetin kuranor:*

(لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ)

"Nata e Kadrut është më e mirë se një mijë muaj".

Muxhahidi (104 h) thotë: *"Falja namaz gjatë kësaj nate është më e mirë sesa vepra e atij njeriu"*⁽¹⁴⁾.

Në një transmetim tjetër, **Muxhahidi** (104 h) thotë: *"Vepra në të, agjërimi i saj dhe falja në të, është më e mirë se një mijë muaj"*⁽¹⁵⁾.

Ndërsa imam **Katade** (117 h) thoshte se është për qëllim: *"Më e mirë se një mijë muaj, pa qenë në to nata e kadrut"*⁽¹⁶⁾. Pra, një mijë muaj, e që në këtë një mishe nuk gjendet në to nata e kadrut, porse netë të rëndomta. E, që një mijë muaj janë baras me 83 vjet dhe 4 muaj.

(14) Shënon Taberiu në "Tefsirin" e tij (24/546).

(15) Po aty, (24/533).

(16) Po aty.

Ndërsa **imam Maliku** (179 h) thotë: Kam dëgjuar njërin nga dijetarët, të cilit i besoj, se: *"Të Dërguarit të Allahut ﷺ i është paraqitur mosha e popujve të mëparshëm, të cilët jetonin gjatë, dhe sikurse e pa se umeti i tij kanë moshën më të shkurtër dhe se me këtë moshë nuk mund t'i arrijnë të tjerët me vepra të mira, atëherë Allahu ia dha atij natën e Kadrit e cila ka vlerë më shumë se një mijë muaj"*⁽¹⁷⁾.

4. Atë natë zbresin melekët (engjëjt) në tokë si dhe caktohen ndodhitë përgjatë një viti.

Thotë, në vazhdim të sures:

{تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ} [القدر: ٤]

"Me lejen e Zotit të tyre, engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili) zbresin në këtë natë me të gjitha vendimet". (El Kadr: 4)

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë për **Natën e Kadrit**:

"Vërtet, ajo është në natën e njëzet e shtatë ose njëzet e nëntë, dhe se atë natë melekët në tokë janë më shumë sesa numri i guralecëvë në të"⁽¹⁸⁾.

(17) "Muvatta Malik" (896).

(18) Shënojnë Ahmedi (10734) dhe Ibn Huzejme në "Sahihun" e tij (2194).

Ibn Kethiri (774 h) thotë se zinxhiri transmetues i këtij hadithi është i mirë⁽¹⁹⁾.

5. *Paqja dhe mirësia mbretërojnë atë natë.*

Dhe thotë në fund të sures:

{سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ} [القدر: ٥]

"Ajo (natë) është paqe deri në lindjen e agimit (mëngjesit)". (El Kadr, 5)

Komentuesi i Kuranit, imam **Katade** (117 h) thotë: *"Paqe dmth: hajr – mirësi është ajo natë"*.

Imam **Ata' ibn ebi Rabahu** (114 h) përcillet të ketë thënë: *"Ka për qëllim: është paqe për të dashurit – miqt e Allahut dhe ata që i binden Atij"*⁽²⁰⁾.

Kurse Imam **Sha'biu** (pas vitit 100 h) thotë se "paqe" – dmth: *"Dhënia selam nga ana e melekëve atyre që shkojnë në xhamia, që nga perëndimi i diellit deri në agimin e mëngjesit"*⁽²¹⁾.

6. *Atij që falet në këtë natë me besim e shpresë tek Allahu, do t'i falen gjynahet e kaluara.*

(19) "Tefsir ibn Kethir" (8/449).

(20) "Tefsiri i Begaviut" (8/491).

(21) Po aty.

Dihet se falja e namazit (qoftë teravi apo namaz nate) gjatë Ramazanit i fal gjynahet e kaluara. I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"Atij që falet gjatë Ramazanit (namaz nate apo teravi) duke besuar e shpresuar (në shpërblim), do t'i falen gjynahet e kaluara" ⁽²²⁾.

Kjo vlen gjatë gjithë Ramazanit, ndërsa për dhjetëshin e fundit kjo bie në pah edhe më shumë, sidomos kur i Dërguari i Allahut ﷺ e ka theksuar këtë çështje në mënyrë të veçantë për **Natën e Kadrit**, ku thotë:

"Atij që falet në natën e Kadrit (namaz nate apo teravi) duke besuar e shpresuar (në shpërblim), do t'i falen gjynahet e kaluara" ⁽²³⁾.

"Duke besuar" d.m.th: me bindje dhe sinqeritet ndaj Allahut, duke besuar Allahun dhe Pejgamberin e Tij.

"Duke shpresuar" d.m.th: duke kërkuar me të ftyrën e Allahut të Lartësuar dhe shpërblimin e Tij ⁽²⁴⁾.

(22) Shënojnë Buhariu (2009) dhe Muslimi (759).

(23) Shënojnë Buhariu (1901) dhe Muslimi (760).

(24) Shih: "Sherh es Sunneh" (1/218).

Kur është nata e Kadrit?

Kjo është nga çështjet që kanë rënë në mospajtim për të shokët e të Dërguarit ﷺ (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) si dhe dijetarët pas tyre, ku el Hafidh **Ibn Haxheri** (852 h) përmend më tepër se 40 mendime në këtë çështje⁽²⁵⁾.

Kurse arsyeja e këtij mospajtimi kthehet te hadithet e ardhura në këtë çështje, ku në vijim do të përmendim më kryesoret prej tyre:

Ubade ibn Samit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ doli për të lajmëruar rreth Natës së Kadrit, në atë çast, dy prej muslimanëve po grindeshin, i Dërguari ﷺ tha:

"Vërtet, unë dola për t'ju lajmëruar rreth Natës së Kadrit, por, meqë filani dhe filani po grindeshin, m'u ngrit (tërhoq) dituria për të. Shpresoj që kjo të jetë më mirë për ju. Andaj, kërkojeni atë në natën e shtatë, të nëntë dhe të pestë"⁽²⁶⁾.

Pra, natën e 27-të, 29-të dhe 25-të të Ramazanit sipas një shpjegimi⁽²⁷⁾.

(25) "Fet'hul Bari" (4/262-266).

(26) Buhariu (49) dhe (2023).

(27) Shih: "Fet'hul Bari", po aty.

Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se disa njerëz nga shokët e të Dërguarit ﷺ e kishin parë Natën e Kadrit në ëndërr, në shtatëshin e fundit (nga dhjetëshi) i Ramazanit, i Dërguari ﷺ tha:

"Po shoh se ëndërrat tua po përputhen në shtatëshin e fundit, andaj kush është prej jush që e kërkon atë, le ta kërkojë atë në shtatë netët e fundit"⁽²⁸⁾.

Në një transmetim tjetër:

"Po shoh se ëndërrat tua - në lidhje me natën e Kadrit- po përputhen në dhjetëshin e fundit, atëherë kërkojeni atë në netët teke të tij (dhjetëshit)"⁽²⁹⁾.

Nga **Ebu Hurejra** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"M'u është treguar nata e Kadrit (duke qenë në gjumë) pastaj më zgjoi dikush nga gratë e mia dhe e harrova atë, andaj, kërkojeni atë në dhjetëshin e mbetur (të Ramazanit)"⁽³⁰⁾.

(28) Buhariu (2015) dhe Muslimi (2761).

(29) Shënojnë Buhariu (6991) dhe Muslimi (2763).

(30) Shënon Muslimi (2768).

Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***"Kërkojeni natën e Kadrit në dhjetëshin e fundit të Ramazanit"***⁽³¹⁾.

Kurse **Ubej ibn Ka'bi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) betohej se: ***"Kjo natë është në natën e njëzet e shtatë"***, kur i thanë se nga e di këtë? Tha: në bazë të shenjave të saj, na ka treguar i Dërguari i Allahut se: ***"në atë ditë dielli lind pa rreze"***⁽³²⁾.

Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"Kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit të Ramazanit, natën e Kadrit, në nëntë (ditë) të mbetura, në shtatë të mbetura dhe në pesë të mbetura"⁽³³⁾.

Kuptimi: **nëntë** ditë të mbetura nga fillimi i dhjetëshit të fundit, pra, kur kalon nata e parë e dhjetëshit e që është nata e 21-të e Ramazanit, mbesin edhe nëntë ditë deri në fund të muajit, e që i bie të jetë nata e 22-të.

Shtatë të mbetura: i bie nata e 24-të.

Dhe **pesë** të mbetura: nata e 26-të⁽³⁴⁾.

(31) Shënojnë Buhariu (2020) dhe Muslimi (2776).

(32) Shënon Muslimi (2777).

(33) Buhariu (2021).

(34) Shih: "Nejlul Eutar" (4/328).

Kështu e ka bërë këtë llogari sahabiu **Ebu Seid el Hudriu** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) siç përcillet në "Sahihun" e imam Muslimit, duke shpjeguar thënien e të Dërguarit ﷺ: ***"Kërkojeni atë në të nëntën, të shtatën dhe të pestën"***⁽³⁵⁾.

Pra, ky hadith tregon se mund të jetë nata e Kadrit edhe në netët çifte.

Imam **Ibn Tejmije** (728 h) thotë: *"Nata e Kadrit mund të jetë në netët teke ose në netët çifte, andaj duhet që besimtari ta kërkojë atë në të gjitha netët e dhjetëshit të fundit"*⁽³⁶⁾.

Gjithashtu, në një transmetim tjetër nga **Ebu Seid el Hudriu** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"Kam hyrë në itikaf"⁽³⁷⁾ ***në dhjetëshin e parë (të Ramazanit) duke kërkuar këtë natë (të Kadrit), pastaj hyra në Itikaf në dhjetëshin e mesëm, pastaj më erdhi dikush (meleku) dhe më është thënë: Vërtet, ajo është në dhjetëshin e fundit..., kam parë (në ëndërr) se ajo***

(35) Muslimi (2774).

(36) "Mexhmu'ul Fetava" (25/285).

(37) **Itikaf** quhet qëndrimi në xhami gjatë dhjetëshit të fundit të Ramazanit me qëllim adhurimi.

është natë teke, dhe se në sabahun e asaj nate do të bëjë sexhde në ujë dhe lloç".

Ebu Seid el Hudriu tregon se: "Shikuam dhe pamë se ajo ishte nata e njëzet e një"⁽³⁸⁾.

Ndërsa, **Abdullah ibn Unejsi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "***Kam parë (në ëndërr) natën e Kadrit, pastaj e harrova atë, (më është hequr nga mendja) dhe kam parë se në sabahun e asaj nate do të bëjë sexhde në ujë dhe lloç".*** **Abdullah ibn Unejsi** tregon, pas këtij hadithi, se këto shenja ishin parë në natën e 23-të⁽³⁹⁾.

Pra, të dy transmetimet janë të sakta, nata e 21-të, dhe 23-të; e që kjo aludon se në një nga vitet në kohën e të Dërguarit ﷺ, në bazë të shenjave, paska qenë në natën e 21-të, ndërsa në një vit tjetër në natën e 23-të. Allahu e di më së miri.

Këto hadithe tregojnë se ajo natë është teke, si dhe aludon se i Dërguari ﷺ e kërkonte atë natë në dhjetëshin e fundit saqë edhe Itikafin e bënte në kërkim të saj, kështu që nuk është një natë e caktuar.

(38) Muslimi (2771).

(39) Muslimi (2775).

Me rëndësi të dihet fakti se shumica e shokëve të Dërguarit janë pajtuar se kjo natë është brenda dhjetëshit të fundit, kurse përcaktimi i një nate të veçantë është pikë diskutimi mes tyre.

Abdullah ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "**Omer ibn Hatabi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i mblodhi shokët e të Dërguarit ﷺ dhe i pyeti ata për natën e kadrut, ku **ata u pajtuan** se ajo është në dhjetëshin e fundit..."⁽⁴⁰⁾.

Andaj, sipas këtyre haditheve dhe transmetimeve (ethereve) të sahabëve, më saktë del mendimi i shumicës së dijetarëve se **Nata e Kadrit** është në dhjetëshin e fundit dhe se ajo lëvizë gjatë këtij dhjetëshi, nuk është e caktuar çdo herë në të njëjtën natë, ku me këtë edhe realizohet bashkimi i të gjitha haditheve të ardhura për të.

El Kadi **Ijad** (544 h) thotë: "*Kanë rënë në mospajtim (dijetarët) lidhur me caktimin e saj, ku një grup dijetarësh thanë se: ajo lëvizë, një vit është në një natë dhe në vitin tjetër në një natë tjetër, e kështu me radhë, ku me këtë edhe bashkohen hadithet, e që thuhet se: secili hadith i ardhur ka treguar njëren kohë të saj dhe nuk ka kundërthënie në to. Ngjashëm me këtë është*

(40) Shënon Abdurrezaku (7679) me zinxhir transmetimi të saktë.

*mendimi i këtyre imamëve: **Malikut, Sufjan eth Theuriut, Ahmedit, Is'hakut, Ebu Theurit**, etj, këta kanë thënë: Ajo lëvizë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit*"⁽⁴¹⁾.

Hafidh **Ibn Haxheri** (852 h) -pasi përmendi në këtë çështje rreth 46 mendime- thotë: "*Mendimi më i afërt qëndron se ajo është në netët teke të dhjetëshit të fundit dhe se ajo levizë (transferohet nga viti në vit) siç kuptohet nga hadithet e këtij kapitulli...*"⁽⁴²⁾.

Allahu e di më së miri.

Ndërsa, urtësia e fshehjes së kësaj nate, apo mos përcaktimi i saktë se kur ndodhet kjo natë, qëndron në arsyen që mos të neglizhohen netët tjera nga njerëzit, porse të jenë në adhurim të vazhdueshëm duke e kërkuar këtë natë dhe duke shpresuar vlerën dhe mirësitë e saj.

Në lidhje me këtë është transmetuar nga **Zejneb bint Umu Seleme** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e cila është pyetur për **Natën e Kadrit**, ku u përgjigj se: "*I Dërguari i*

(41) "Sherh Sahih Muslim" të Neveviut (8/57).

(42) "Fet'hul Bari" (4/266).

Allahut ﷻ nuk e dinte atë, e sikur ta dinte atëherë njerëzit nuk do të faleshin në netët tjera përveç saj"⁽⁴³⁾.

Ky transmetim edhe pse ka dobësi në të, megjithatë tregon një realitet të natyrshmëria e njerëzve, ku vërtet sikur ta dinin saktë atë, nuk do të bënin aq përpjekje në adhurim dhe vepra të mira siç bëjnë në atë natë, për të cilën mendojnë se është **Nata e Kadrit**, siç ndodh me shumë muslimanë të cilët mendojnë se kjo natë është e caktuar në natën e 27-të, ku i gjen ata se i frekuentojnë xhamitë dhe faltoret në këtë natë, kurse në natën e radhës nuk gjen prej tyre vetëm se pak! Kurse ne pamë në transmetimet e përmendura, se si i Dërguari i Allahut ﷺ hynte në itikaf në kërkim të **Natës së Kadrit** gjatë dhjetëshit të fundit, gjë që tregon se kjo natë nuk është e caktuar dhe se ajo lëvizë përgjatë këtij dhjetëshi të Ramazanit.

Imam i shquar i tabi'inëve, **Ebu Kilabe el Xhermi** (104 h) ka thënë: *"Nata e kadrit transferohet (lëvizë) në dhjetëshin e fundit në netët teke"*⁽⁴⁴⁾.

(43) Shënon Merveziu në "Muhtesar Kijam el Lejl" (f. 247). Zinxhiri i transmetuesve është i saktë, përveç Abdullah ibn Lehias, i cili ka dobësi në të.

(44) Shënon Abdurrezaku (7699) me zinxhir transmetimi të saktë.

- **Shenjat e saj:**

Shenja kryesore e **Natës së Kadrit** e përmendur në hadith të saktë, është se në sabahun e asaj nate: **"Dielli lind pa rreze"**⁽⁴⁵⁾.

Në një transmetim tjetër: **"Dielli i asaj nate, atë ditë lind i bardhë, pa rreze në të"**⁽⁴⁶⁾.

Në një transmetim tjetër përmendet se: **"Duket sikurse hëna"**, pra pa rreze.

Thuhet se kjo shenjë është për shkak të numrit të madh të melekëve që zbresin atë natë në tokë, saqë prej tyre nuk duken rrezet e diellit në momentin kur lind⁽⁴⁷⁾, porse nuk ka argument të qartë për këtë, ndonëse mund të dëshmojë për të hadithi që kemi përmendur më parë se: **"atë natë melekët në tokë janë më shumë sesa numri i guralecëve në të"**⁽⁴⁸⁾.

Kurse ajo çka përmendet nga shenjat e kësaj nate, përveç këtyre, në përgjithësi janë hadithe të dobëta. Allahu e di më së miri.

(45) Shënon Muslimi (2777).

(46) Shënon Muslimi (1785).

(47) Shih: "Ikmal el Mu'lim bi Fauaid Muslim" (4/148).

(48) Shënojnë Ahmedi (10734) dhe Ibn Huzejme në "Sahihun" e tij (2194).

Udhëzimi i të Dërguarit në dhjetëshin e fundit

Nga suneti⁽⁴⁹⁾ i të Dërguarit ﷺ është gjallërimi i netëve të fundit të Ramazanit me adhurim, si dhe zgjimi i familjarëve, grave e fëmijëve, ashtu që ta arrijnë vlerën dhe mirësinë e këtyre netëve.

Nga disa hadithe kuptohet se i Dërguari i Allahut angazhohej me adhurim gjatë këtyre dhjetë netëve më shumë se në çdo kohë tjetër, ku udhëzimi i tij në këto netë mund të përmbliidhet si në vijim:

Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se: ***"I Dërguari ﷺ bënte përpjekje (me adhurim) në këto dhjetëshe të fundit, gjë që nuk e bënte një përpjekje të tillë në ditët tjera"***⁽⁵⁰⁾.

Pra, nga udhëzimi i të Dërguarit ﷺ ishte: përpjekja sa më e madhe në adhurim gjatë këtij dhjetëshi, dhe atë me të gjitha llojet e adhurimit, si:

- Falja namaz nate: ku i falte nga 11 rekate duke e zgjatur kijamin (qëndrimi në këmbë në namaz) me lexim, rukunë dhe sexhden me lutje.

(49) Fjala "**Sunet**" është për qëllim me të tradita e të Dërguarit të Allahut ﷺ, e cila përfshin: fjalët dhe veprat e tij, si dhe çdo vepër ose fjalë e cila ka ndodhur duke qenë i Dërguari ﷺ i pranishëm dhe e ka aprovuar atë.

(50) Muslimi (1175).

- **Leximi i Kuranit:** ku i Dërguari ﷺ takonte Xhibrilin (alejhi selam) në çdo natë të Ramazanit dhe e lexonte Kuranin para tij⁽⁵¹⁾.

- **Sadakaja:** ku siç përcillet se i Dërguari ﷺ ishte më bujari nga të gjithë njerëzit, ndërsa në Ramazan ishte edhe më bujar sesa ditëve tjera. **Ibn Abasi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se: ***"I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu më bujar, kurse më bujar se çdo herë ishte gjatë Ramazanit kur e takonte Xhibrilin (alejhi selam), e takonte atë çdo natë të Ramazanit ku dhe e mësonte Kuranin me të. I Dërguari i Allahut ﷺ ka qenë më bujar në vepra të mira sesa era që fryn (e që sjell mirësi)"***⁽⁵²⁾.

Po ashtu, **Aisheja** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se: ***"Kur hynte dhjetëshi i fundit i Ramazanit, i Dërguari ﷺ shtrëngonte rripin, gjallëronte natën me adhurim dhe e zgjonte familjen e tij"***⁽⁵³⁾.

Nga ky hadith vijnë në pah dy pika të rëndësishme:

E para: Përkushtimi në adhurim. Siç u përmend në hadith: (وَشَدَّ الْمِثْرَ) ***"shtrëngonte rripin"***, është për qëllim përkushtimi i madh në adhurim dhe anashkalimi i gjërave të dunjasë, ndërsa imam **Sufjan eth Theuri** (161

(51) Shënojnë Buhariu (4997) dhe Muslimi (2308).

(52) Shënojnë Buhariu (6) dhe Muslimi (2308).

(53) Shënojnë Buhariu (2024) dhe Muslimi (1174).

h) e shpjegon se është për qëllim: *"Nuk u afrohej grave të tij"*⁽⁵⁴⁾ gjatë këtyre netëve, për shkak të angazhimit dhe përpjekjes së tij të shumtë me adhurime.

E dyta: Zgjimi i familjes. Siç përmendi nëna e besimtarëve, **Aisheja**, se i Dërguari ﷺ e zgjonte familjen e tij në këto netë për të falur namaz. Ky udhëzim është mëse i rëndësishëm, ku besimtari është i urdhëruar që të kujdeset për familjen e tij dhe për ata që i ka nën kujdes, ashtu që t'i kap për dore drejt udhëzimit dhe nënshtrimit ndaj Allahut, në mënyrë që ta arrijnë shpërblimin edhe ata bashkë me të, siç thotë Allahu i Lartësuar në Kuran:

{يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ}
[التحریم: ٦]

"O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët".
(Tahrim, 6)

Në lidhje me këtë, përcillet nga **Aisheja** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se: *"E zgjonte familjen e saj në natën e njëzet e tretë"*⁽⁵⁵⁾.

(54) "Musanefi" i Abdurrezakut (4/253).

(55) Shënon Ibn Ebi Shejbe (9541) me zinxhir transmetimi të saktë.

El Esued en Nehaiu (75 h) thotë: *"Aisheja na zgjonte në natën e njëzet e tretë të Ramazanit"*⁽⁵⁶⁾.

Gjithashtu, **Abdullah ibn Abasi** (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se: *"E stërpikte familjen e tij me ujë natën e njëzet e tretë"*⁽⁵⁷⁾, ashtu që të zgjohen dhe ta gjallërojnë këtë natë me namaz e adhurim.

- **Itikafi** – qëndrimi në xhami me qëllim adhurimi- gjatë dhjetëshit të fundit. Nga udhëzimi i të Dërguarit ﷺ gjithashtu ishte edhe itikafi.

Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se:

"I Dërguari ﷺ hynte në itikaf në dhjetëshin e fundit të Ramazanit derisa vdiq, pastaj gratë e tij hynin po ashtu në itikaf pas tij"⁽⁵⁸⁾.

Këtë adhurim i Dërguari ﷺ e bënte çdo Ramazan; prej që është bërë obligim agjërimi, ku gjithsej ka agjëruar 9 ramazane, në të gjitha bënte **itikaf** përveç tre herë; dy herë për shkak se ishte i zënë me xhihad – luftë në rrugë të Allahut, në luftën e Bedrit dhe në çlirimin e Mekës, ku të dyja këto lufta kanë ndodhur në Ramazan; dhe herën e tretë kur deshtën të hyjnë me të në itikaf gratë e tij pa

(56) Shënon Abdurrezaku (7695) me zinxhir transmetimi të saktë.

(57) Shënon Ibn Ebi Shejbe (9540) me zinxhir transmetimi të saktë.

(58) Shënojnë Buhariu (2026) dhe Muslimi (1172).

e informuar atë, gjë që e bëri që i Dërguari ﷺ ta lë itikafin atë vit, ku dhe e kompensoi atë më pas në muajin Sheval⁽⁵⁹⁾.

Mbyllja e të Dërguarit ﷺ në itikaf në dhjetëshin e fundit, duke qenë se drejtonte shtetin islam, jepte fetva dhe duke pasur ummeti nevojë për të, është argument se më e udhës është të vonohen apo të shtyhen disa dobi për shkak të këtij dhjetëshi.

• Pastrimi në Natën e Kadrit

Nuk është transmetuar ndonjë hadith i saktë që tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ pastrohej në këtë natë. Kjo gjë ka ardhur nga disa prej selefëve – gjeneratave të para, gjegjësisht tabi'inëve⁽⁶⁰⁾.

Abdullah ibn Sherik thotë: "E kam parë **Zirr ibn Hubejshin** (83 h) -nga tabi'inët e mëdhenj- ndërkohë që Haxhaxhi hipi në minber duke folur për natën e kadrit sikurse tha se disa njerëz po e përmendin natën e kadrit, sakaq **Zirr ibn Hubejshi** deshi t'ia vërtetojë atë që tha, porse njerëzit e penguan atë, atëherë, **Zirr ibn Hubejshi** tha: *"Ajo është nata e njëzet e shtatë, kush e arrin atë **le të pastrohet**, le të bëjë iftar me qumësht dhe le ta hajë*

(59) Shënojnë Buhariu (2026) dhe Muslimi (1172).

(60) Tabi'inët janë gjenerata pas sahabëve - shokëve të të Dërguarit ﷺ.

atë në kohë të syfyrit"⁽⁶¹⁾. Pra, le ta shtyejë ngrënien e iftarit deri në syfyr.

Ndërsa, imami i shquar **Ibrahim en Nehaiu** (96 h) përcillet se: "*Lexonte Kuranin (e bënte hatme atë) gjatë muajit Ramazan në çdo tri ditë, ndërsa kur hynte dhjetëshi i fundit, e lexonte atë në çdo dy ditë dhe **pastrohej** çdo natë*"⁽⁶²⁾.

Gjithashtu, imam **Ejub es Sehtijani** (131 h) përcillet se **pastrohej** dhe parfumosej në natën e njëzet e tretë⁽⁶³⁾. Pra, në kërkim të **Natës së Kadrit**.

(61) Shënon Abdurrezaku (7701) me zinxhir transmetimi të mirë (hasen).

(62) Shënon Abdurrezaku (7705) me zinxhir transmetimi të saktë.

(63) "Musane'fi" i Abdurrezakut (4/250).

Cili adhurim është më i dobishëm gjatë këtyre netëve?

Së pari, u bë e ditur se gjallërimi i tërë natës me namaz në këto dhjetë netë është nga udhëzimi i të Dërguarit ﷺ, **Aisheja** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë:

"I Dërguari ﷺ njëzet ditët e para i përziente mes namazit dhe gjumit (edhe falej edhe flinte), ndërsa kur ishte dhjetëshi i fundit u përvilte dhe shtrëngonte rripin!". Pra, i përvishej adhurimit dhe nuk flinte me gratë e tij.

Ndërkaq, adhurimet janë të shumëllojshme e që më parësore dhe njëkohësisht më të dashura tek Allahu janë:

- **adhurimet e obliguara (farzet)**

Prej tyre në radhë të parë **pesë kohët e namazit**, të cilat muslimani duhet të kujdeset t'i kryejë në kohën e tyre, si në Ramazan ashtu edhe jashtë tij.

- **adhurimet vullnetare (nafilet)**

Ndërsa, pas farzeve, vijojnë **adhurimet vullnetare**, e në krye të tyre është **namazi**, si: ai i teravisë, namazi i natës, i paraditës (duhasë), sunetet përcjellëse të farzeve (sunen rauatib), etj.

- **namazi i teravisë**

nga suneti profetik dhe nga tradita e muslimanëve brez pas brezi është edhe falja e namazit të teravisë gjatë Ramazanit, siç përmendëm në hadith se: ***"Atij që falet gjatë Ramazanit duke besuar e shpresuar (në shpërblim), do t'i falen gjynahet e kaluara"***⁽⁶⁴⁾. Dhe se për qëllim është teravisë dhe namazi i natës në përgjithësi. Imam **Neveviu** (676 h) thotë: ***"Është për qëllim "falja" (në këtë hadith) namazi i teravisë, ku janë pajtuar dijetarët se teravia është e pëlqyer"***⁽⁶⁵⁾.

Kjo vlen gjatë gjithë Ramazanit në përgjithësi dhe për dhjetëshin e fundit në veçanti, sidomos kur i Dërguari i Allahut ﷺ ka theksuar të njëjtën thënie në mënyrë të veçantë për **Natën e Kadrit**.

Mjafton për vlerën e teravisë hadithi që përcjellë **Ebu Dherri** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***"Kush falet me imamin derisa ai t'i kryejë, i shkruhet për të sikur të falej tërë natën"***⁽⁶⁶⁾.

(64) Shënojnë Buhariu (2009) dhe Muslimi (759).

(65) "Sherh Sahih Muslim" (6/39).

(66) Shënojnë Ebu Davudi (1375), Tirmidhiu (806), Nesaiu (1364) dhe Ibn Maxhe (1327). Imam Tirmidhiu (279 h) thotë: "Ky është hadith i saktë, i mirë (hasen sahih)"

Pra, sikur të falet një natë të plotë⁽⁶⁷⁾. Andaj, përpiku të falesh këto netë teravitë me imam derisa ai t'i kryejë ato, ashtu që ta arrish shpërblimin e të falurit tërë natën.

• leximi i Kuranit

Prej tyre: **leximi i Kuranit**, ku njëherit është nga adhurimet më të vlefshme në këtë muaj.

Allahu i Lartësuar – siç përmendëm më herët-, na ka treguar se Ramazani është muaji në të cilin ka zbritur Kurani i Madhërishëm, fjala e të Madhit Zot, libër i bekuar, udhëzues për njerëzimin. Andaj, përderisa ky muaj është muaji i Kuranit, është e pëlqyer leximi i Kuranit në të sa më shumë, sepse kjo ishte edhe tradita e Xhibrilit (alejhi selam), ku zbritte nga qielli çdo natë në Ramazan dhe ia lexonte Kuranin të Dërguarit tonë Muhamedit ﷺ.

Me lexim të Kuranit pushojnë shpirtërat, qetësohen zemrat dhe shtohet imani, siç thotë në Kuran:

{إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ} [الأنفال: ٢]

(67) "Tuhfetul Ahuadhi bi Sherh Xhami" et Tirmidhi" (3/438).

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu frikësohen dhe, kur u lexohen ajetet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten". (Enfal, 2)

I Dërguari ﷺ thotë: ***"Kush e lexon një shkronjë nga Libri i Allahut do të shpërblehet me një të mirë, kurse një e mirë (tek Allahu) shpërblehet me dhjetë sosh, nuk them se "elif - lam - mim" është një shkronjë (apo fjalë), por Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë"***⁽⁶⁸⁾. Pra, për çdo shkronjë që lexon ke shpërblim dhjetë të mira (sevape).

Më së miri është të lexohet Kuran në namaz, pra gjatë të falurit, qoftë në teravi apo namaz nate në përgjithësi.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjellë se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***"A dëshiron ndonjëri prej jush që kur të kthehet te familja e tij të gjëjë tri deve (me barrë) të mëdha e të majme? Thanë: Po.***

I Dërguari ﷺ tha: ***"Tri ajete kuranore që ndonjëri prej jush i lexon në namazin e tij është më mirë për të sesa tri deve të mëdha e të majme"***⁽⁶⁹⁾.

(68) Shënon Tirmidhiu (2910) dhe tha: "Ky hadith është i saktë, i mirë, i panjohur nga kjo rrugë transmetimi (hasen sahih garib)".

(69) Shënon Muslimi (802).

Imam **Neveviu** (676 h) thotë: *"Dije se leximi më i mirë i Kuranit është kur lexohet në namaz"*⁽⁷⁰⁾.

Imam **Ibn Tejmije** (728 h) thotë: *"Leximi i Kuranit në namaz është më i mirë sesa jashtë tij dhe se vlera e transmetuar për lexuesin e Kuranit e përfshin atë që lexon në namaz më shumë se që e përfshin dikë tjetër"*⁽⁷¹⁾.

Andaj, është e pëlqyer leximi i Kuranit sa më shumë, qoftë në namaz, qoftë jashtë tij.

• lutja – duaja

Pastaj vjen me radhë: **lutja – duaja**, siç përmendet në hadithin e **Aishes** (radijAllahu anha), e cila e pyeti të Dërguarin ﷺ se çfarë të thotë nëse e qëllon natën e Kadrit, i tha: Thuaj:

"Allahume inneke Afuwun tuhibul afve f'afu anni".

(O Zot! Ti je Falës, e do faljen, andaj, më fal mua).

Alahu i Madhëruar thotë:

{وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ
فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ} [البقرة: ١٨٦]

(70) "el Edhker" (f. 199).

(71) "Fetava" (23/282).

"Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë". (Bekare, 186)

Ky ajet kuranor gjendet në Kuran në mesin e ajeteve që flasin për dispozitat e agjërimit, prandaj urtësia qëndron në atë se Allahu i Lartësuar u përgjigjet lutësit kur ai është agjërueshëm, pra të qenurit agjërueshëm është nga shkaqet e pranimit të lutjeve.

Imam **Ibn Kethiri** (774 h) thotë: *"Meqë Allahu i Lartësuar përmendi këtë ajet kuranor kaq nxitës për lutje, duke e ngërthyer atë mes dispozitave të agjërimit; kjo paraqet udhëzim nga Ai që: rob i të bëjë përpjekje sa më shumë në lutje pas plotësimit të kohës (së agjërimit) bile pas çdo iftari"*⁽⁷²⁾.

Ndërsa në një hadith, i Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

"... dhe për çdo njërin prej tyre (agjëruesve) ka një lutje të pranuar"⁽⁷³⁾.

Pra, ndër veprat më të mira në dhjetë netët dhe në **Natën e Kadrit**, janë: **"namazi, kurani dhe lutja"**; e gjendja më e mirë është – siç e përmendin disa dijetarë:-

(72) "Tefsiri i ibn Kethirit" (1/509).

(73) Shënon Ahmedi (7450) me zinxhir transmetimi të saktë.

bashkimi i këtyre tri veprave në **namaz**: duke e zgjatur namazin me lexim Kurani dhe me zgjatje të sexhdes duke u lutur.

- **dhikri** (përmendja e Allahut)

Prej veprave të mira gjithashtu: **dhikri** (të përmendurit e Allahut), qoftë gjatë natës por edhe gjatë ditës duke qenë agjërueshëm, sepse dhikri ia shton vlerën çdo vepe, e lëre më agjërimit.

Për këtë, imam **Ibrahim en Nehaiu** (96 h) thoshte: *"Një tesbih (thënia Subhanallah) në Ramazan është më e mirë sesa një mijë tesbihe jashtë tij"*⁽⁷⁴⁾.

Ndërsa imam **Ibn Kajimi** (751 h) ka thënë: *"Njerëzit më të mirë të çdo vepe, janë ata që më së shumti e përmendin Allahun në të; andaj, agjëruesit më të mirë janë ata që më së shumti e përmendin Allahun në agjërimitin e tyre; më të mirët nga ata që japin sadaka, janë ata që më së shumti e përmendin Allahun e Madhëruar... e kësisoj të gjitha veprat tjera"*⁽⁷⁵⁾.

- **itikafi**

Itikafi është mbyllja në xhami me qëllim adhurimi, i cili adhurim bëhet në çdo xhami në të cilën falen pesë kohët

(74) "El Xhami'u" të imam Axhurrit (2/1172).

(75) "El Uabil es Sajjib" (f. 181).

e namazit, kjo vepër është nga sunetet profetike, ku i Dërguari i Allahut ﷺ vazhdimisht e praktikonte atë siç përmendëm më parë, këtë e praktikuan pas tij edhe gratë e tij si dhe gjithë muslimanët në të gjitha kohërat.

- **ndihmesa, sadakaja dhe dhënia ushqim**

Përmendëm më parë se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu më bujar, kurse bujaria e tij shtohet edhe më shumë në Ramazan, andaj është e pëlqyer dhënia sadaka gjatë këtij muaji, ushqimi i të varfërve, nevojtarëve, por edhe miqve e të afërmeve, duke shtruar iftare e syfyre. Kjo është nga simbolet e islamit.

Imam **Zuhriu** (125 h) kur hynte muaji Ramazan thoshte: *"Vërtet, ai është muaj i leximit të Kuranit dhe i dhënies ushqim"*⁽⁷⁶⁾. Pra, të ushqyerit e njerëzve.

Ndërsa, **Ibn Tejmije** (728 h) thotë: *"Ndihmesa e të varfërve me të ushqyer në muajin Ramazan është nga traditat e islamit"*⁽⁷⁷⁾.

- **istigfari**

Istigfari, thënia **"estagfirullah"** dmth: të kërkosh nga Allahu që të të fal.

(76) "Letaif el Mearif" (f. 171).

(77) "Fetava" (25/298).

Istigfari është nga shkaqet më të mëdha të faljes së gjynaheve, e sidomos nëse thuhet kjo lutje gjatë agjërimit, ku përmendëm më herët se agjëruesit i pranohet lutja, andaj është e pëlqyer të thuhet **istigfari** në çdo kohë, për shkak të shpërblimit të madh që ka, siç përcjellë **Abdullah ibn Busri** (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari ﷺ ka thënë:

"Tuba për atë i cili gjen në regjistrin e tij shumë istigfar"⁽⁷⁸⁾. Kurse **"tuba"** është përgëzim, thuhet se është një pemë nga pemët e Xhenetit, ku hija e saj është sa të ecësh një mijë vjet⁽⁷⁹⁾. Pra, lum për atë i cili gjen sa më shumë **istigfar** në regjistrin e tij Ditën e Gjykimit, për shkak të mirësive të mëdha dhe shpërblimit që ka për robin.

Në disa transmetime përcillet se Iblisi ka thënë: *"I shkatërrova njerëzit me mëkate, kurse ata më shkatërruan mua me **"la ilahe il – Allah"** dhe me **"istigfar"** (kërkim falje)"*⁽⁸⁰⁾.

Imam **Ibn Rexhebi** (795 h) thotë: *"Istigfari është përfundimi i të gjitha veprave të mira, me të përfundohet namazi, haxhi, namazi i natës, me të përfundohen mexhliset (ndejat) nëse ato kanë qenë mexhlise të*

(78) Shënon Nesaiu në "el Kubra" (10216) dhe Ibn Maxhe (3818).

Zinxhiri i transmetimit është i mirë (hasen).

(79) Shënon Ibn Hibani në "Sahihun" e tij (7413).

(80) "Letaif el Mearif" (f. 214).

*dhikrit, istigfari për to është sikurse vula në fund, e nëse kanë qenë mexhlise të kota, atëherë ai është shpagim për ta, për këtë arsye duhet që të përfundohet agjërimi i Ramazani me istigfar, **Omer ibn Abdulazizi** përcillet se u shkroi vendeve të cilat i kishte nën pushtet dhe i urdhëroi ata që: **ta mbyllin Ramazanin me istigfar dhe me zekat të fitrit**”⁽⁸¹⁾.*

Si dhe vepra tjera të cilat janë të ligjshme në çdo kohë, gjithashtu janë të ligjshme dhe të pëlqyera edhe në këto dhjetë netë, ku në to hyn çdo vepër që Allahu i Lartësuar e ka bërë të ligjshme dhe është i kënaqur me të.

Pastaj, secili person mund të zgjedhë prej këtyre adhurimeve atë që mund ta kryejë më me zell dhe më lehtë, për arsye se njerëzit ndryshojnë nga njëri - tjetri në aspektin e besimit, ambicies, dëshirës dhe vullnetit që kanë, andaj çdo njëri vepron atë që e sheh më të dobishme për vetën e tij.

Imam **Ibn Tejmije** (728 h) ka thënë: *"Prej njerëzve ka që për dikë më i dobishëm është leximi i Kuranit sesa namazi (vullnetar), për dikë tjetër të përmendurit e Allahut (dhikri) është më i dobishëm sesa leximi dhe ka prej tyre që përpjekja në lutje (dua) është më e dobishme për të sesa dhikri ndaj të cilit ndoshta mund të jetë*

(81) Po aty.

neglizhent... andaj, njohja e gjendjes së çdo personi dhe asaj se çka është më e dobishme për të, nuk mund të përmblihet në një libër, porse para së gjithash kjo ka nevojë për udhëzim që Allahu e udhëzon me të robin e Tij në atë që është më e mirë... "⁽⁸²⁾.

E rëndësishme është që të mos kalojë ndonjë çast nga këto ditë vetëm se duke qenë në adhurim (ibadet), duke mos nënvlerësuar asnjë vepër sa do e thjeshtë që të jetë, siç përmendet në hadith: **"Frikësojuni Allahut qoftë edhe me një gjysmë hurme (duke dhënë sadaka), nëse nuk gjen, atëherë me një fjalë të mirë"**⁽⁸³⁾, në qoftë se edhe këtë nuk ke mundësi, atëherë jo më pak se: **"të takosh vëllanë tënd fytyrë çelur (i buzëqeshur)"**⁽⁸⁴⁾, siç ka ardhur në hadith tjetër.

(82) "Fetava" (22/309).

(83) Shënojnë Buhariu (6023) dhe Muslimi (1016).

(84) Shënojnë Tirmidhiu (1970) dhe Ahmedi (14709). Imam Tirmidhiu thotë: "Hadithi është i saktë, i mirë (hasen sahih)".

Si ta arrijmë (në praktikë) shpërblimin e Natës së Kadrit?

Së fundi, disa udhëzime praktike se si të jemi sa më aktiv dhe sa më efikas gjatë gjithë këtyre dhjetë netëve, me shpresë që ta arrijmë **Natën e Kadrit** me lejen e Allahut të Madhëruar.

Sipas thënieve profetike të sakta që u përmendën më heret, i bie që kjo natë është në njërën nga dhjetë netët e fundit të muajit Ramazan.

Para së gjithash, këshillojmë në pastrimin e nijetit dhe përtrirjen e tij para këtij dhjetëshi të bekuar.

Pastaj, që të jesh prej atyre që dëshirojnë ta arrijnë këtë natë në adhurime e vepra të mira, mundohu të veprosh si vijon:

- 1- Fale namazin e teravisë dhe namazin e natës çdo natë.
- 2- Jep sadaka (lëmoshë) çdo natë, qoftë edhe sado pak.
- 3- Lexo Kuran sa më shumë që është e mundur.
- 4- Shpeshtoj çdo natë lutjen: **"Allahume inneke Afuwun tuhibul afve f'afu anni"**. Në shqip:

(O Zot! Ti je Falës, e do faljen, andaj, më fal mua!).

5- Përmende Allahun sa më shumë, çdo natë, sidomos fjalët: ***"Subhanallah, Elhamdulillah, la ilahe il-Allah, Allahu ekber"***, të cilat janë fjalët më të dashura tek Allahu.

6- Kërko falje sa më shumë ***"estagfirullah"***: (o Zot më fal!), çdo natë.

7- Mundohu këto netë, ta thuash nga 100 herë thënien: ***"La ilahe il-Allahu uahdehu la sherike lehu, lehu mulku ue lehu hamdu, ue Huve ala kul-li shejin kadir"***.

8- Veçohu nga të tjerët në këto netë dhe largohu nga vizitat apo tubimet që s'kanë dobi.

9- Mundohu mos ta përdorësh telefonin këto netë vetëm se në rast nevojë a domosdoshmërie, ngase ai është bërë hajduti më i madh i kohës!.

10- Ji i qetë sa më shumë dhe qëndro larg diskutimeve e debateve.

11- Lute Allahun sa më shumë të të bëjë prej të pranuarve!.

Përfundim

Së fundi, mundohu që gjatë këtij muaji, e posaçërisht gjatë dhjetëshit të fundit, të jesh prej atyre që garojnë në vepra të mira, çfarëdo qofshin ato, të mos kalojë ndonjë çast për ty nga këto netë të bekuara, vetëm se duke qenë në adhurim: ose duke u falur, ose në sexhde, ose duke lexuar Kuran, ose duke u lutur, ose duke kërkuar falje, ose duke përmendur Allahun.

Le të jenë këto ditë të bekuara pishtar ndriçues për ty gjatë tërë vitit, përfundoje këtë muaj me pendim të sinqertë ndaj Allahut, ndoshta Allahu ta mundëson ta përfundosh jetën tënde me mirësi, siç thuhet në hadith: **"Vërtet, veprat llogariten (shpërblehen) sipas përfundimit"**⁽⁸⁵⁾.

Premtoji Allahut **se:** do të largohesh nga gjërat e ndaluara gjatë tërë vitit, ashtu siç u largove prej tyre në këto ditë; **se:** do të vazhdosh në vepra të mira, ashtu siç u angazhove me to gjatë këtyre ditëve, falënderojë Atë për këtë dhunti që ta dha, ji mirënjohës ndaj Tij dhe lute Atë për më shumë begati për ty në këtë botë dhe për falje, kënaqësi dhe rehati të përjetshme në botën tjetër.

85 Shënon Buhariu (6607).

Lusim Allahun e Madhërishëm që ashtu siç na mundësoi ta arrijmë muajin e Ramazanit dhe na lehtësoi agjërimin e tij, të na mundësojë t'i arrijmë edhe këto dhjetë netë të fundit, të na i lehtësojë adhurimet në to, të na jep suksese e begati në vepra të mira dhe së fundi të na i fal gjynahet dhe të na bëjë prej të pranuarve, amin!

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Literatura

1. Kurani Fisnik.
2. El Edhker, Neveviu.
3. El Mexhalis er Ramadanije, Abdurrahman ed Duhami.
4. El Musanef, Abdurrezak es San'ani.
5. El Musanef, Ibn Ebi Shejbe.
6. El Uabil es Sajjib, Ibn Kajim el Xheuzije.
7. El Xhami'u el Kebir (es Sunen), Tirmidhiu.
8. El Xhami'u li Kutub Imam el Axhurri, Adil Hamdani.
9. Es Sunen el Kubra, Nesaiu.
10. Es Sunen, Ebu Davudi.
11. Es Sunen, Ibn Maxhe.
12. Es Sunen, Nesaiu.
13. Fet'hul Bari, Ibn Haxheri.
14. Hutab ue Durus, Abdurrahim Tahhani.
15. Ikmal el Mu'lim bi Fauaid Muslim, el Kadi Ijad.
16. Letaif el Mearif, Ibn Rexhebi.
17. Mexhmu' el Fetava, Ibn Tejmije.
18. Muhtesar Kijam el Lejl, Muhamed ibn Nasr el Merveziu.
19. Musnedi i Ahmedit.
20. Mustalahat fi Kutub el Akaid, Muhamed Hamadi.

21. Muvatta, Malik ibn Enes.
22. Nejl el Eutar, Sheukani.
23. Sahihu i Buhariut.
24. Sahihu i Ibn Hibanit.
25. Sahihu i Ibn Huzejmes.
26. Sahihu i Muslimit.
27. Sherh es Sunneh, Begaviu.
28. Sherh Sahih Muslim, Neveviu.
29. Tefsiri i Begaviut.
30. Tefsiri i Ibn Ebi Hatim.
31. Tefsiri i Ibn Kethirit.
32. Tefsiri i Taberit.
33. Tuhfetul Ahuadhi bi Sherh Xhami' et Tirmidhi,
Mubarekfuri.

Përmbajtja

Hyrje	6
Vlera e dhjetëshit të fundit	11
Nata e Kadrit dhe vlera e saj	14
Kuptimi: el kadr	14
Kur është nata e Kadrit?	22
Shenjat e saj	30
Udhëzimi i të Dërguarit në dhjetëshin e fundit	31
Falja namaz nate	31
Leximi i Kuranit	32
Sadakaja	32
Përkushtimi në adhurim	32
Itikafi	34
Pastrimi në Natën e Kadrit	35
Cili adhurim është më i dobishëm gjatë këtyre ..?	37
Adhurimet e obliguara (farzet)	37
Adhurimet vullnetare (nafilet)	37
Namazi i teravisë	38
Leximi i Kuranit	39

Lutja – duaja	41
Dhikri (përmendja e Allahut)	43
Itikafi	43
Ndihmesa, sadakaja dhe dhënia ushqim	44
Istigfari	44
Si ta arrijmë shpërblimin e Natës së Kadrit?	48
Përfundim	50
Literatura	52
Përmbajtja	54